



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14058/1 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

Lënda: Dërgim i procesverbaleve të konsultimit publik të PBA 2026–2028 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

DREJTORISË SË FINANCËS, KONTABILITETIT DHE BUXHETIT ✓

Në bazë të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, urdhërit nr.89, datë 02.04.2025 “Për Caktimin e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, po ju përcjell procesverbalet e mbajtura gjatë takimeve në njësitë administrative për konsultimin publik të PBA 2026–2028 dhe planifikimin për projektbuxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultimin Publik
Aurora Kamberaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 1

DATË 11.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025.

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit z.Skerdilaid Hunda, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxha, anëtar të këshillit bashkiak, drjtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha: Ju uroj shëndet të gjithëve dhe ju falenderoj për praninë tuaj në këtë takim konsultativ.Ky proces do të zhvillohet në dy faza, me qëllim që të identifikojmë problematikat aktuale dhe të kuptojmë më mirë nevojat e komunitetit, në mënyrë që ato të pasqyrohen sa më drejt në buxhetin e vitit 2026. Fillimisht, do të paraqes disa nga projektet që Bashkia Vlorë ka parashikuar për këtë vit, dhe më pas do të ndalemi te çështjet dhe sugjerimet që vijnë nga komuniteti Një nga projektet kryesore është rikonstruksioni i shkollës “4 Heronjtë”, i cili është përfshirë tashmë në buxhet. Aktualisht po përgatitet ndërhyrja në fushat e shkollës, ndërsa objekti i shkollës do të kalojë së shpejti në procedurë tenderimi. Ky është një projekt me vlerë mbi 2 milion euro. Gjithashtu, kemi parashikuar mobilimin e shkollës, me një vlerë prej 70 milion lekësh të vjetra, për të pajisur 120 klasa. Një tjetër ndërhyrje është rialokimi i fondeve për rikonstruksionin e rrugës së Kuzum

Babasë, duke nisur nga zona e Mesaplikut dhe në drejtim të anës tjetër të rrugës. Po ashtu, është parashikuar edhe rikonstrukcioni i shkallëve të Kuzum Babasë, që aktualisht ndodhen në procedurë tenderimi. Ndërkohë, ka nisur edhe investimi për rikonstrukcionin e një pjese të rrugës pranë ish-Fabrikës së Çimentos. Sa i përket hapësirave publike, bashkia ka hartuar një listë të gjerë objektsh për t'u prishur, në bashkëpunim me IMT dhe IKMT, me qëllim lirin dhe sistemimin e tyre në funksion të komunitetit. Këto ishin disa nga projektet e parashikuara. Në vijim, do të dëgjojmë opinionet, propozimet dhe shqetësimet tuaja, për të ndërtuar së bashku një buxhet të drejtë dhe gjithëpërfshirës për vitin 2026.

Z.Flamur Habilaj/Banor, Mbështesim fjalimin tuaj. Zona përreth spitalit ka nevojë urgjente për investime, si dhe rruga "Bilbil Ceno". Te kinemaja duhet të merren masa për heqjen e shtyllës dhe kallëmbave që pengojnë qarkullimin. Gjithashtu, është e nevojshme të vendoset një ure në përrua për të përmirësuar lidhjen dhe qarkullimin në zonë.

Z. Ermal Dredha, kemi kryer punimet në rrugën e spitalit, përfshirë ndriçimin dhe vendosjen e kangjullave për të shmangur aksidentet. Sa i përket heqjes së kallëmbave, dua të theksoj se ato janë në pronësi private, prandaj ndërhyrja jonë është e kufizuar në këtë aspekt.

Z. Edi Cani, qyteti ka humbur kreativitetin për shkak të mungesës së vendeve që ofrojnë mundësi për zhvillim dhe aktivitete kreative. Është e domosdoshme restaurimi i ish-kallëve të Kuzum Babasë në mënyrë që të jenë funksionale dhe të përdorshme për banorët.

Gjatë bulevardit Vlorë - Skelë kërkoj heqjen e autobuzave të mëdhenj dhe zëvendësimin e tyre me mjete më të vogla për të përmirësuar qarkullimin dhe për të zvogëluar ngarkesën.

Gjithashtu, duhet të bëhet spostimi i topave, pasi nuk çdo projekt është i përsosur dhe duhet të përshtatet sipas nevojave reale të qytetit.

Znj. Adelina Ibrahim, është e nevojshme shtrimi dhe asfaltimi i rrugës së shkollës "28 Nëntori", rruga që nis nga shkolla dhe ka dalje në ish-Aluiznin Kuzum Baba. Gjithashtu, duhet pastrimi i kanaleve të jashtme në zonën rrethues të shkollës "28 Nëntori" për të parandaluar përmytjet dhe për të ruajtur higjienën. Është e domosdoshme ndriçimi i rrugëve të brendshme në lagjen "Hajro Cakëri" për të rritur sigurinë e banorëve gjatë natës.

Po ashtu, duhet të krijohet një qendër informimi për turistët, që do të ndihmojë në promovimin e turizmit lokal dhe orientimin më të mirë të vizitorëve. Në fund, kërkohet vendosja në funksion të shatërvanit në Sheshin e Flamurit për të përmirësuar pamjen dhe ambientin në këtë zonë qendrore të qytetit.

Z. Krenar Cakëri, si banor, kërkojmë vendosjen e tualeteve publike për të përmirësuar kushtet dhe shërbimet për qytetarët. Gjithashtu, është e nevojshme krijimi i një qendre për lajmërimi për njerëzit që ndërrojnë jetë. Po ashtu, kërkojmë vendosjen e një cange pranë Sahatit të Vlorës për të lehtësuar organizimin dhe shërbimet në atë zonë.

Qytetar, kam biznes në lagjen Muradie. Kërkoj pastrimin urgjent të kanaleve, pasi përmytjet nga shirat e fundit po krijojnë shumë probleme për banorët dhe bizneset në zonë.



Qytetar, jam banor i lagjes “Hajro Cakërrri” dhe dua të theksoj se rruga “Zoto Mahmuti” ka nevojë urgjente për lirim e hapësirave publike, pasi aktualisht nuk mund të kalojnë as ambulanca, zjarrfikësja dhe asnjë mjet tjetër emergjent.

Gjithashtu, kërkoj rregullimin e rrugës “Muharrem Rushiti”, pasi problemet e mbartura prej kohësh ndikojnë negativisht në qarkullimin dhe sigurinë e banorëve.

Ju uroj suksese në realizimin e buxhetit dhe shpresoj që këto çështje të marrin vëmendjen e duhur.

Qytetar, jam banor dhe kërkoj shtrimin e disa rrugicave në lagjen “Hajro Cakërrri”.

Z. Ermal Dredha, ju falenderoj dhe shpresoj të takohemi përsëri në shtator.

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftimi dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 2

DATE 12.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025.

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniq Merkuri, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit z. Orest Ruçi, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxha, anëtar të këshillit bashkiak, drjtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha: Përshëndetje,

Kemi filluar një seri takimesh në të gjitha rajonet dhe njësitë administrative për buxhetin 2026. Kjo është faza paraprake për të marrë indicie që të jemi sa më efikasë në planifikimin e buxhetit. Kemi parashikuar një projekt është aktualisht në fazën e tenderimit dhe shpresojmë të përfundojë deri më 15 tetor, me qëllim të fillojmë investimet e planifikuara. Rruga te Shkolla “Tregtare” është përfunduar me asfaltim, trotuar dhe ndriçim. Kemi bërë një projekt të ri për Shkollën “Ismail Qemali”, është parashikuar rikonstruksioni i kopshtit “1 Maj”. Do të krijohen dy parkime nën-tokësore me dy kate për të lehtësuar trafikun. Te Hoteli “Duka”, aktualisht përdoret si parkim pa pagesë, por po realizohet një projekt i ri që shpresojmë të përfundojë deri në shtator. Sheshi përballë Universitetit ka marrë një fond prej 10 milion euro për një parkim

nën-tokësor me dy kate për të akomoduar një numër të madh makinash. Rruga “Mevlan Drevishi” do të rikonstruktohet, dhe do të bëhet pastrimi i kanalit “Siav”. Po planifikohet gjithashtu rregullimi i plotë i kanalit për ta kthyer në një zonë atraktive. Do të furnizojmë 300 kosha plastik për pastrimin e qytetit. Rruga të “7 Pallatet” është bërë me asfaltim dhe vijëzim. Lulishtja të “Kali i Trojës” ka përfunduar, por ka nevojë për disa ndryshime. Në lidhje me hapësirat publike, do të nisë një aksion i gjerë, duke filluar nga Lungomare dhe në të gjitha territorët dhe lagjet, për të parandaluar abuzimin e hapësirës publike. Sugjerimet tuaja janë të mirëpritura. Në shtator do të flasim për vendosjen e masave konkrete dhe për gjëra specifike që kërkojnë vëmendje.



Banor i lagjes “10 Korriku”, pranë shkollës “Avni Rustemi”, kemi problem: Rrugët e brendshme të lagjes janë të pa shtruara dhe kanë nevojë për rikonstrukcion. Prania e qenve endacak pranë zonave të banuara është shqetësuese dhe kërkon ndërhyrje me prioritet. Kanalizimet dhe kolektorët kryesorë duhet të pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht. Duhet bllokimi i lejeve për ndërtimet e reja po bëhen pa kriter. Ka nevojë për ndriçim të mjaftueshëm brenda lagjes. Duhet të sigurohet siguria teknike e pallateve që po ndërtohen.

Z. Ermal Dredha, janë vendosur gjoba për ndërtimet pa leje, dhe gjithashtu janë sterilizuar 250 qen.

Znj. Zamira Sinaj, duhet të shqyrtohet qendra e qenve, pasi situata është shqetësuese për banorët dhe është e nevojshme pastrimi i zonës.

Banor, Problemi janë gropat e shkaktuara nga punimet e ujësjellësit, që pengojnë lëvizjen e mjeteve.

Z. Vasillaq Merko, pranë Shkollës ‘Ismail Qemali’ ka nevojë për lirim të hapësirës publike, pasi pengon lëvizjen e njerëzve dhe të mjeteve.

Znj. Majlinda Duraj, banore e lagjes Uji i Ftohtë. Është ngritur një hotel pa respektuar lejen e ndërtimit, dhe shtesa e bërë pengon qarkullimin e mjeteve të domosdoshme për jetën e përditshme të banorëve. Kërkohe ndërhyrja për zgjidhjen e situatës. Inspektor, është mbajtur akt-konstatim, çështja dërgohet në prokurori.

Znj. Majlinda Duro, zona ka nevojë për pastrim, vendosje sinjalistike dhe pastrimin e kanaleve, pasi është një zonë turistike.

Z. Ermal Dredha, ndërtimi nuk është kryer sipas planifikimit urban. Po punojmë për ta parandaluar këtë dhe ju kërkojmë kohë për të stabilizuar situatën.

Banor i lagjes “Pavarësia”, mungesa e administratorit të pallateve po shkakton konflikte mes Banorëve.

Z. Ermal Dredha, Bashkia po merret me trajnimin e administratorëve të pallateve. Në disa

pallate të reja, kërkesa për administrator është refuzuar për shkak të pagesës. Tani, kjo është një detyrim ligjor: çdo pallat duhet të ketë administrator.

Banor i lagjes “Uji i Ftohtë” Kalaja. Ndërtuesi ka bllokuar hyrjen, duke penguar qarkullimin.

Banor, të hiqen koshat e plehrave të lulishtja pranë Mjekësorës dhe të pastrohet ura.

Banor i lagjes “Bujar Leskaj”, problem rruga të Tiku e Mato.

Banor i lagjes “Uji i Ftohtë”, problem me zënien e hapësirës publike dhe kalimin për të Shkolla “Tregtare”. Kjo zonë ka nevojë për koshat e mbeturinave.

Banor i pallatit Cobo Center. Ka nevojë urgjente për administrator pallati. KFC që ndodhet pranë është problematik, pasi erërat e ushqimeve depërtojnë në banesat tona. Për më tepër, nuk janë përgjegjës për hedhjen e mbeturinave dhe kanë zënë hapësirën publike të përbashkët.

Z.Ermal Dredha, KFC ka krijuar probleme për shkak të abuzimeve me mbetjet e biznesit. Do të vazhdojmë me kontrolle për të marrë masat e nevojshme.

Banor, Pranë shkollës ‘Ismail Qemali’ kërkojë heqjen e mbeturinave të shkaktuara nga hapja e kanaleve. Nevojitet përmirësimi i kalçetos së lagjes ‘Isa Boletini’ dhe heqja e koshave të plehrave pranë saj. Lagjja ka nevojë gjithashtu për ndriçim dhe hapësira parkimi.

Banor i lagjes Pavarësia, kërkon pastrim të zonës dhe përmirësim të kanalizimeve.

Banor, shërbimi i transportit publik është i kufizuar. Kabinat elektrike pranë Qendrës së Qenëve janë mbushur me mbetje dhe kërkojnë pastrim.

Z. Ermal Dredha, Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 3

DATË 13.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetare e Rajonit 3 znj. Manuela Prifti, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxha, anëtar të këshillit bashkiak, drjtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë- Z. Ermal Dredha:Përsëndetje,

Kemi filluar një sërë takimesh për buxhetin e vitit të ardhshëm, me qëllim që të ballafaqohemi me atë çfarë është realizuar dhe çfarë mbetet ende për t’u bërë. Aktualisht janë disa investime të rëndësishme në proces: Rikonstruksioni i shkollës “Lef Sallata” dhe shtimi i klasave, fond i dedikuar për mobilimin e shkollës.

Rikonstruksioni i kopshtit nr.10 (proçesi i tenderimit ka përfunduar, vlere rreth 310 milion lekë të vjetra). Problem mbetet sigurimi i ambientit për transferimin e fëmijëve.

Rikualifikimi i tregut artizanal pranë ish-fabrikës së orizit (në pritje të përfundimit të procedurës).

Rikualifikimi i lulishtes pranë shkollës “Ali Demi”.

Ndërtimi i një kullishteje pranë shkollës “Ali Demi” pas lirimit të hapësirës publike.

Rikonstruksioni i bllokut të banimit të ish-sigurimeve (rreth 589 milion lekë të vjetra).

Rikualifikimi i hapësirës së rrugës Transballkanike (në fazë procedure tenderimi).

Asfaltimi dhe vijëzimi i rrugës “Albano Romina”, me nevojën për të rishikuar edhe pjesën e parkimit.

Hapësira pranë rrugës “Kosova” (Albidea), në proces tenderimi.

Projekti për lulishten pranë Universitetit (punimet nisin në shtator).

Objekte publike e kulturore:

Godina e gjendjes civile (në pritje financimi). Qendra Kulturore e Fëmijëve.

Parkimi nëntokësor pranë Universitetit, me vlerë rreth 10 milion euro, pritët finalizimi i projektit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Aplikim pranë Fondit të Zhvillimit për teknologjinë e autobusëve elektrikë të vegjël dhe instalimin e karikuesve në zonë.

Pastrimi i zonës Mbrapa Xhambos, por kërkohet edhe ndërgjegjësim i banorëve.

Plani për shtimin e rreth 300 koshave plastikë, si dhe 50 kosha nëntokësorë që tashmë i kemi në dispozicion.

Sot jemi këtu për të marrë mendimet dhe sugjerimet tuaja, në mënyrë që të planifikojmë më mirë buxhetin për vitin 2026.



Banor: Pse nuk po zbatohet vendimi i IMT për prishjen e objektit të paligjshëm në lagjen “1 Maj”?

Z. Ermal Dredha: Ky problem do të zgjidhet dhe do të ndiqet nga afër deri në përfundim.

Banor: E konsideroj privilegj që jam pjesë e këtij takimi. Dëshiroj të ndaj disa problematika si qytetar:

Para Bashkisë ndodhet një objekt i pashfrytëzuar – pse nuk përdoret?

Rikonstruksioni i Muzeut Hebraik.

Sheshi i Flamurit ka mbetje që duhet të pastrohen; gjithashtu nevojiten stola në lulishten përreth.

Pas monumentit ndodhet shatërvani, i cili nuk funksionon.

Objekti para hotelit mbetet pa funksion të qartë – çfarë parashikohet për të?

Shkallët e Kuzum Babasë kanë nevojë për rikonstruksion.

Përballë Conad ndodhet një vepër kulturore pa emërtim.

Te “Kali i Trojës” duhen vendosur stola.

Parku i lojërave “Albano e Romina” është i lënë në gjendje të shkretë.

Në lulishten kryesore mungon një tualet publik.

Ka nevojë për vendosjen e çezmave publike.

Linja e autobusëve duhet të shtohet me mjete 25-vendëshe.

Stacioni i trenit është i pushtuar nga qentë endacakë.

Busti i Ismail Qemalit ka nevojë për ndërhyrje pasi pllakat bien.

Z. Ermal Dredha, para Bashkisë, lulishtja është realizuar me Fondet e Zhvillimit. Po shqyrtohet mundësia e ndërtimit të një parkimi nëntokësor, i cili do të lidhet me pjesën pas Bashkisë. Gjithashtu, pranë Muzeut Hebraik parashikohet të kryhen ndërhyrje restauruese, ndërsa në Sheshin e Flamurit do të shtohen disa stola për qytetarët.

Është kryer pastrimi i shatërvanit me qëllim rikthimin e tij në identitet.

Po shqyrtohet rikthimi në funksion i tualetit ekzistues.

Te “Kali i Trojës” – Jemi në proces vlerësimi për mënyrën më të përshtatshme të ndryshimit.

Parku i lojërave “Aulona” – Një pjesë e sipërfaqes ka rezultuar me pronarë privatë, duke krijuar mbivendosje pronësie.

Qendra Kulturore e Fëmijëve – Me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit do të transformohet plotësisht në një hapësirë moderne për fëmijët.

Banor: Kalcetoja pranë qendrës kulturore është jashtë standardeve dhe ka nevojë për ndërhyrje.

Banor: Rruga midis pallateve pranë shkollës “Lef Sallata” është e amortizuar dhe ka nevojë për asfaltim. Gjithashtu, kemi problem me shpërdorimin e ujit të pijshëm. Pallatet e vjetra ndodhen në gjendje të amortizuar dhe duhen suvatuar.

Z. Ermal Dredha: Është e nevojshme të parashikohen puse për bizneset që kanë lokale. Po ashtu, mund të përzgjidhet një numër pallatesh për t’u suvatuar, duke u bërë me dakordësinë e banorëve.

Banor: Me lavazhot çfarë do të bëhet?

Z. Ermal Dredha: Masat do të merren për të gjithë, sidomos në zonat e banuara.

Banor: Kemi nevojë për gjelbërim të qytetit dhe për pastrimin/zhbllokimin e hapësirës publike pranë Studio Bleta.

Banor: Është nevoja për asfaltim të 80 metrave rruge nga Alpet deri te Metabo.

Banor: Kërkohet semafor për rregullimin e qarkullimit dhe shtim i linjës së autobusëve.

Banor: Kemi problem me bojlerët.

Z. Ermal Dredha: Do të bëjmë lëvizjen e bolierëve, kur ujesjellësi është në funksion, bolierët dalin jashtë funksionit.

Banor i lagjes Varosh: Gjatë shirave kemi probleme me përmytjet. Kërkojmë ndërhyrje urgjente për përmirësimin e sistemit të kullimit.

Banor: Rruga te Cipajt është e prishur dhe kërkon ndërhyrje urgjente.

Banorë: Problem me parkimin pranë Hotel Bruklin.

Z. Ermal Dredha: Projekti është duke u realizuar.

Banor: 2 pallate paralel zaptuan hapësirën publike dhe hedhin mbeturina. Duhet administrator pallati, si dhe stola te lulishtja, Kali i Trojës.

Z. Ermal Dredha: Emërimi i administratorit për çdo pallat është bërë i detyrueshëm. Problemi kryesor mbetet pagesa nga banorët, por çdo pallat do të ketë administratorin e tij.

Banor: Në zonën e ish-Kombinatit kemi nevojë për shtim të gjelbërimit, rregullim të rrugëve dhe heqje të pengesave nga parkimi i makinave. Nevojiten gjithashtu ndriçim dhe pastrim i zonës.

Z. Ermal Dredha: Po hasim pengesa në realizimin e investimeve në lagje për shkak të situatës me ujësjellësin.

Znj. Vera Zaho: Problemi im i mbartur lidhet me objektet e palegalizuara pranë Kopshtit 'Binjakët' dhe kërkoj ndërhyrjen tuaj për zgjidhjen e situatës.

Banor: Përgëzoj për projektin e Tregut të Orizit. Megjithatë, lulishja pranë Selis ka nevojë për investim, përfshirë ndriçim, asfaltim dhe vendosjen e stolave. Ka problem edhe me infrastrukturën e brendshme, si dhe nevojë për lirim të hapësirës publike. Duhet të hiqen inertet e shkaktuara nga uji i ujësjellësit. Gjithashtu, duhet të trajtohen parkimet abuzive dhe të bëhet vijëzimi për parkim.

Znj. Edlira Kapllani: Nevojë emergjente për ngritjen e një çerdhe shtetërore. Te Konad, problem parkimi, i cili është burim konflikti mes njerëzve.

Banor: Pallatet e reja janë pa numër. Rruga "Kozma Gjilo" të vendoset një tabelë informuese.

Z. Ermal Dredha: Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 4

DATE 14.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit z. Donald Leskaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxha, anëtar të këshillit bashkiak, drjtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha:Përshëndetje,

Ky është takimi i parafundit për buxhetin 2026. Një nga problemet shqetësuese që nuk po merr zgjidhje është ujësjellësi, i cili po pengon punën tonë.

Kemi disa projekte: rikualifikimin e lulishtes në rrugën “Fan Noli”, rikonstruksionin e Pallatit 1300, barrierat mbrojtëse të Shkollës “Ali Demi”. Do të fillojmë me prishjen e Vola për të rregulluar pjesën e trafikut. Po ashtu, kemi rikonstruksionin e rrugës “Bejko Sala” dhe tualeteve të Shkollës 15 Tetori. Ndërhyrje dhe pastrim në kanalin “Naunka”. Rikonstruksionin e rrugës tek pallatet e Gorishtit, rrugën “Sazani” dhe godinën e Rajonit 4.



Znj. Mimoza Naka: Pallati 1387 ka nevojë për ndërhyrje në disa fusha: pastrim të përgjithshëm, pastrimin e pusetave të bllokuara, zgjidhjen e problemit të parkimit të makinave, krijimin e një lulishteje para pallatit, vendosjen e ndriçimit, lirim të hapësirës së përbashkët publike dhe restaurimin e pallatit.

Z. Nuredin Vesha: Në lagjen tonë kemi nevojë për shtrimin e rrugës “Mehmet Halemi”, krijimin e një lulishteje, përmirësimin e ujërave të zeza, si dhe për trajtimin e qenve endacakë që shqetësojnë qytetarët.

Z. Ermal Dredha: Kemi bashkëpunuar me një nga shoqatat që merret me trajtimin e qenve endacakë, pasi ky është një problem i rëndësishëm dhe i mbartur.

Banor: Rruga që të çon te kali duhet të ketë vijëzim. Nevojë për asfaltim dhe ndriçim të rrugës “Miss Durham”.

Banor: Banoj te njëkatëshi ku ka nevojë për ndriçim, rregullimin e pusetave pa kapak, asfaltimin e 50 metrave rrugë dhe pastrimin e pusetave të bllokuara.

Banor: Kabina elektrike te Pylli 6 është e hapur. Tubacionet e ujërave të zeza janë të reja, por nuk janë vënë ende në përdorim.

Banor, Problemi i makinave të harruara po shkakton konflikte mes banorëve. Të mbulohet kanali i Naunkës.

Znj. Dorina Ferhati: Te kabina elektrike, çdo dy ditë ndërrim celësi, pasi banorët e zonës e shqyejnë atë.

Banor: Janë vendosur shtyllat por është këputur kabulli elektrik, jemi pandricim.

Banor, Problem me kapakët e pusetave dhe ndriçimin pranë pallateve te Gorishit.

Znj. Dorina Ferhati: Janë 300 ndriçues të rinj që do të shpërndahen nëpër shtylla.

Banor, Nevojiten vendosja e dy kontenierëve në rrugën “Zonja Curre” dhe mbulimi i kanalit të Naunkës.

Banor: Kam një biznes pranë kanalit. Ju lutem, më jepni leje për pastrimin dhe mbulimin e tij.

Banor: Rruga “Enver Jaho” ka problem me ujërat e zeza dhe ka nevojë për shërbimin urban me një orar më të zgjeruar.

Banor: Kërkohet asfaltim rrugësh, rikonstruksion trotuarësh dhe pastrim natën për të mos bllokuar qarkullimin.

Z. Ermal Dredha: Pastrimi vazhdon gjatë gjithë ditës, pasi nuk respektohet orari i hedhjes së plehrave.

Banor: Te rruga “Riza Salati” të bëhet asfaltimi i rrugës dhe lirim i hapësirës publike.

Banor: Të prishen godinat dhe të zbatohet projekti I parë. Te pallatet 1100, 1101 nevojiten 8 stola.

Banor I lagjes 24 Maj: Problem me legalizimin e shtëpisë.

Z. Ermal Dredha: Ne jemi ndërmjetës psi është procedurë e AShK

Z. Muqerem Memushi: Nevojë për zgjerimin e urës te rruga Fan Noli, si dhe për realizimin e tubacioneve.

Banor i lagjes “1 Maj”: Kemi nevojë për heqjen e mbeturinave dhe zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës.

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 5

DATË 15.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025.

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit z.Bledar Toja, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zeraq, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxha, anëtar të këshillit bashkiak, drjtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha:

Ju falenderojmë shumë që jeni këtu sot. Kemi filluar prej gati një jave vizitat në të gjitha rajonet dhe njësitë administrative për të diskutuar së bashku lidhur me projektbuxhetin. Së shpejti do të fillojmë punimet në lulishten e drejtorisë së policisë, duke përfshirë vendosjen e disa stolave. Ndërkohë, do të ndërhyjmë edhe në rrugën e lagjes “Kushtrim”. Po ashtu, kemi rikonstruksionin e kopshtit nr. 14 me vlerë 70 milion lekë të vjetra, si dhe rikonstruksionin e tregut të frutave dhe perimeve. Gjithashtu, kemi realizuar ndërhyrje të ripërtëritshme në disa pallate të vjetra dhe rikonstruksionin e rrugës “Zenel Gjoleka”, e cila ndodhet pranë ujësjellësit.

Duam sugjerimet tuaja, në mënyrë që të analizojmë se çfarë mund të parashikojmë dhe, në shtator, të vijmë me një plan konkret. Fokus i veçantë do të jetë edhe lirimi i hapësirave publike. Do të doja të dëgjoja me më shumë vëmendje nga ana juaj të gjitha problematikat që keni identifikuar.



Z. Zenun Fasllia, banor i lagjes “Pus Mezin”: Vuaj mungesën e ujit të pijshëm. Gjithashtu, theksoi se rruga është e pashtuar dhe kërkoi vendosjen e llambave në rrugën “Leonidha Naço”.

Banor: Prej kohësh vuajmë mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm. Për këtë arsye, kemi vendosur të përgatisim një peticion drejtuar institucioneve përgjegjëse për të kërkuar ndërhyrje të menjëhershme në përmirësimin e ujësjellësit.

Banor i lagjes “Kushtrim”: Kemi nevojë për trotuare rreth 300 metra, si dhe shtrimin e rrugës mbrapa KSHA, pasi përdoret çdo ditë nga fëmijët për të shkuar në shkollë dhe në kopsht.

Banor i lagjes Lirim, duhet të hiqen postera informues të vendosur në vende të papërshtatshme

Banor: Te rruga “Osmen Haxhiu” kërkojë zgjerimin dhe shtrimin e rrugës, që të mund të hyjnë ambulanca dhe zjarrfikësja, si dhe parandalimin e përmytjeve nga shirat përmes sistemit të kullimit.

Banor i lagjes “Kushtrim”: Një pjesë e rrugës “Dervish Hekali” është për t’u rikonstruktuar, pasi nuk është kryer asnjë ndërhyrje deri më tani. Rruga ka nevojë për ndriçim, veçanërisht në lagjen “Kushtrim”

Z. Arqile Balliu: Kemi një problem me ujin.

Znj. Dorina Merdani: Pse nuk merren masa administrative ndaj personave që hedhin mbeturinat në mënyrë të parregullt?

Z. Ermal Dredha: Jemi duke vendosur gjoba pa kufi, por në praktikë i adresojmë kryesisht ndaj biznesit, pasi ata janë abuzuesit kryesorë.

Znj. Dorina Merdani: Lëvizja e automjeteve të pastrimit të qytetit gjatë orëve të ditës shkakton bllokime dhe trafik në qytet, duke penguar qarkullimin normal të mjeteve dhe duke krijuar vonesa për qytetar.

Z. Ermal Dredha: Lufta më e madhe që kemi është ndërgjegjësimi i popullatës, pasi shumë qytetarë nuk respektojnë oraret e hedhjes së mbetjeve. Si rezultat, pastrimi vazhdon gjatë gjithë ditës, duke shkaktuar vështirësi në organizim.

Znj. Dorina Merdani: Kur do të mbyllen kanalet e hapura për ujin?

Z. Ermal Dredha: Afati përfundimtar është muaji maj.

Znj. Dorina Merdani: Marrja e makinave me karrotrec paraqet një problem, pasi mungojnë tabelat informuese.

Z. Ermal Dredha: Së pari, nëse nuk ka shenjë parkimi, nuk duhet të parkosh aty. Së dyti, ka biznese që paguajnë tarifën vjetore.

Znj. Dorina Merdani: Problem përbën edhe parkimi i makinave të braktisura që qëndrojnë të bllokuara gjatë gjithë vitit.

Z. Ermal Dredha: Kemi tre projekte të mëdha parkimesh, të cilat do të realizohen me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit.

Banorët e pallatit nr. 535 raportojnë problem me depozitat e ujit, të cilat bllokojnë qarkullimin e banorëve dhe automjeteve. Nevojitet ndërhyrje urgjente për pastrim ose zhvendosje të tyre.

Z. Ermal Dredha: Me dakordësinë e banorëve, është bërë lëvizja e bollierëve

Banor: Kërkojmë krijimin e një këndi lojrash publik, pa pagesë, për fëmijët e lagjes, ku ata të mund të luajnë në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshëm.

*Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik
Aurora Kamberaj*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR

DATË 14.08.2025 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Kryetari i N.J.A.Qendër- z.Genard Fegaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zera, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxha, Anëtar të Këshillit Bashkiak, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Z. Ermal Dredha: Përsëritje, ju uroj shëndet të gjithëve!

U bë dita e katërt që ne po shkojmë në çdo rajon dhe njësi administrative, sa i përket buxhetit për vitin që vjen dhe për të folur edhe për problematikat që normalisht dua t’i marr nga ju. Po ashtu edhe për punët që Bashkia Vlorë ka bërë dhe ka planifikuar. Po e nis me rrugën e fshatit Babicë, e cila është në fazën përfundimtare. Vazhdojmë me rrugën e varrezave në Kaninë, e cila është hedhur në procedurë, siç ishte parashikuar këtë vit. Kemi bërë zgjerimin e rrugës së varrezave në Babicë dhe gjithashtu kemi shtuar dje çezma. Kemi dy pika panoramike në bypass-in e Kaninës, për të cilat shpresojmë të fillojnë sa më shpejt. Po ashtu kemi filluar

procedurën për rrugën e Panajas, duke përfshirë edhe fushën e sportit. Ndërkohë kemi projektin e parkimit publik të fshatit Zvërnec, gjithashtu dhe hapësirat publike të shkollës “Xhemil Bregu” në Panaja. Kemi rikonstruksionin e rrugës “Xhyherina” si dhe rrugët e brendshme të fshatit, si edhe rrugën e Tragjasit, Radhimës, Skrofotinës dhe Shushicës Gjithsesi, pres sqarime nga ju për të parë si do ta planifikojmë buxhetin për vitin që vjen.



Banor i fshatit Kerkovë, kemi nevojë për rregullimin e rrugëve brenda fshatit pasi janë jashtë funksionit. Po ashtu, rrugët që të çojnë te parcelat e tokës e vështirësojnë vajtjen në to. Rruga Kerkovë–Hoshtimë ka nevojë për shtrim, pasi është rreth 800 metra e pa asfaltuar

Z. Luan Haruni, banor i fshatit Bestrovë, ju falënderoj për vëmendjen që keni ndaj zonave rurale. Fshati ka nevojë për shtrim me çakëll të rrugës që të çon te depot e ujit, për sistemimin e rrugës së varrezave si dhe për ndriçimin e fshatit Bestrovë.

Banor i fshatit Zvërnec, problemi kryesor është furnizimi me ujë, pasi një lagje merr vetëm gjysmë ore ujë çdo tre ditë. Rruga e brendshme, më pak se 400 metra, ka nevojë për shtrim në mënyrë që të drejtohen ujërat. Po ashtu, rrugët e brendshme që kalojnë nëpër parcela janë jashtë funksionit. Sheshi para kishës ka nevojë për ndërhyrje, ndërsa çezma e vjetër duhet restauruar pasi është pjesë e trashëgimisë kulturore të fshatit.

Znj. Kimete Ferrunaj, banuese në Ali Kokë, rruga që ndahet nga bypass-i në pjesën veriore është problematike pasi është e pakalueshme.

Banor i fshatit Hoshtimë, te varrezat janë djegur selvitë të cilat duhen hequr dhe duhet pastruar territori. Fshati vuan mungesën e ujit, një pjesë është pa ndriçim dhe gjysma e rrugës e pashtuar. Banor i fshatit Panaja, prej 4 vitesh nuk është bërë asnjë investim. Vuajmë mungesën e ujit, ka nevojë për ndriçim dhe rregullimin e rrugëve. Qendra shëndetësore kërkon rikonstruksion, ndërsa duhet pastruar kolektori i kanalit dhe sistemi sportiv i fshatit ka nevojë për ndërhyrje.

Banor i fshatit Babicë, Të gjitha rrugët kanë nevojë për rregullim për të mundësuar kalimin e ambulancës dhe zjarrfikëses. Rrjeti i ujit, kanali i ujërave të zeza dhe rreth 80 m rrugë pranë shkollës kanë nevojë për ndërhyrje.

Banor i fshatit Panaja, ka nevojë për zgjerimin e varrezave, pasi nuk ka më vend.

Banor i fshatit Xhuherinë, problemet kryesore janë rrugët e brendshme dhe ndriçimi. Rruga nga bypass-i deri te ferma është e amortizuar dhe ka nevojë për rikonstruksion.

Z. Ermal Dredha, rruga e Xhuherinës është hedhur në tender, ndërsa për ndriçimin do të ndërhyhet së shpejti.

Banor i Babicës së Madhe, kemi nevojë për shërbimin urban, pasi shumë nxënës kanë nevojë për këtë shërbim.

Banor i fshatit Bestrovë, kërkoj ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrugës kryesore, e cila përdoret nga mbi 100 kamionë në ditë, që qarkullojnë edhe gjatë natës. Rregullimin e rrugës që të çon drejt varrezave. Zgjidhjen e problemit me ndriçimin dhe furnizimin me ujë. Rregullimin e rrugës pranë liqenit të Bestrovës, e cila është e amortizuar dhe kalon brenda fshatit.

Banor i fshatit Kaninë, kërkoj hapjen dhe vënien në funksion të rrugës Kaninë–Sherishtë (rreth 500 m) për shfrytëzimin e 200 ha tokë, si dhe pastrimin e kanalit ekzistues. Rruga nëpër parcela është e papërdorshme. Kërkoj rregullim të saj, zgjidhje për furnizimin me ujë dhe vëmendje për pallatin në Sheshin e Kaninës.

Anëtar i Këshillit, kërkoj rregullimin e rrugës Kerkovë që lidh Hoshtimën pasi janë të amortizuar.

Vendosjen e 10 kolektorëve. Rregullimin e rrugës së parcelave, të cilat janë të amortizuara.

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14057 prot.

Vlorë, më 24.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

DATE 11.08.2025 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025

Marrin pjesë:

Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkyetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Kryetari i N.J.A.Orikum, z.Selim Haskocelaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak - z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës - z. Hiqmet Haxha, Anëtar të Këshillit Bashkiak, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.
(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetare e Këshillit Bashkiak Vlorë, znj.Elpiniki Mërkuri:

Ndjesë në emër të Kryetarit të Bashkisë për shkak të ngarkesës momentale dëgjuesën publike do ta zhvilloj unë si Nënkyetare e Këshillit Bashkiak së bashku me Nënkyetaren e Bashkisë Vlorë-znj.Irena Toshkallari. Do të trajtojmë së bashku të gjitha problematikat dhe sugjerimet tuaja që ju mendoni se janë urgjente dhe janë shumë të nevojshme për komunitetin. Të futen në buxhetin e këtij viti për gjithë zonën e Orikumit, Dukatit, po ja jap fjalën znj. Irena Toshkallari dhe më pas vijojmë me diskutimet e tjera.

Nënkryetarja e Bashkisë Znj. Irena Toshkallari: Sot jemi mbledhur për të diskutuar dy dokumenta të rëndësishëm financiar për mbarëvajtjen e gjithë punës për projekt buxhetin



afatmesëm 2026-2028 dhe projektin e buxhetit 2026. Përpara se të jap fjalën drejtorit të financës për të bërë një shpjegim të hollësishëm se ku konsiston i gjithë buxheti doja të ndalesha në disa pika dhe punë që ne i kemi kryer apo që prashikojmë të realizojmë për vitin 2025, të cilat ende nuk kanë përfunduar. Janë në proces pune, këndi sportiv, rikonstruksioni i rrugës së Radhimës dhe dy rrugët e brendshme të Tragjasit me vlerë 50 milion lekë të reja si dhe lerat e betonit të Tragjasit dhe Radhimës. Njëkohësisht janë duke u përgatitur ana e dokumentacionit për rrugën “Jul Çezari” është fondi në buxhet, tani po bëhen procedurat nga drejtoria përkatëse, këndi sportiv i shkollës, këto janë të gjitha në proces të cilat do të realizohen jemi duke bashkëpunuar me Fondin Shqiptarë të Zhvillimit, ka filluar pjesa e rikonstruksionit të fasadave dhe sapo të përfundoj sezoni turistik do të filloj dhe pjesa e bulevardit. Njëkohësisht janë bërë dhe 8 rrugë të brendëshme urbane në Dukat të Ri nga Fondi Shqiptarë i Zhvillimit. Për dy rrugët të cilat ishin parashikuar më herët i zvendësuam me 8 rrugë në Dukat të Ri do ti parashikojmë në fondin e buxhetit të vitit 2026. Këto janë në vija të përgjithshme cfarë kemi bërë dhe cfarë janë në proces duke realizuar , për më tepër për dy dokumenta të rëndësishëm financiar do të flas Drejtori i Financës.

Drejtor i Financës – Z. Hqmet Haxha: Të nderuar pjesëmarrës,

Vijmë në këtë dëgjese publike për të marrë mendimin dhe shqetësimet tuaja për përgatitjen përfundimtare të PBA 2026-2028, si dhe të Buxhetit Vjetor 2026.

Kjo procedurë parashikohet krahas dispozitave të tjera ligjore në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.23 datë 30.7.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësitve të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit nr.3 datë 28.02.2025 “për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”.

Përgatitja e PBA 2026-2028 është një proces që filloi me miratimin e tavaneve buxhetore në mars të vitit 2025, vazhdoi me miratimin e tavaneve të shpenzimeve brenda 30 Qershorit të cilat janë të miratuara me Vendime përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Vlen të theksoj se tregueset e PBA 2026-2028 janë bazë për Buxhetin e vitit 2026.

Miratimi i PBA 2026-2028 nga Këshilli Bashkiak do të bëhet bashkë me Buxhetin e vitit 2026 brenda muajit Dhjetor 2025, prandaj duke e parë në këtë kuadër mendimet dhe sugjerimet tuaja janë shumë të domosdoshme për të arritur të ndërtojmë një buxhet realist i cili t’u shërbejë qytetarëve.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri:Fillojmë me problematikat e qytetarëve dhe cfarë sugjeroni.

Biznesmen Z. Shpend Mustafa: Rruga është e amortizuar , ujërat e zeza duhet të thahen , pompa duhet të jetë në funksion , gjithashtu duhet rikonstruksion i rrugës pasi është pasqyra e Orikumit, ata nuk na shohin ndryshe po na shohin me atë rrugën atje.

Anëtar i Këshillit Bashkiak Z.Arsen Bellaj:Problemi më i madh janë plerat dhe mungesa e ujit, kjo është një zonë turistike. Kjo zonë ka nevojë për vëmendje, ne jemi njësi me të ardhura, me resurse me biznese pa fund, jemi Qendra më e madhe administrative. Një problem tjetër është edhe hapësira publike. SPL-ja në Orikum nuk duhet të paguhet 4000 lekë m2 por me 100 lek m2. Duhet më shumë vëmendje.

Nënkryetarja e Bashkisë Znj. Irena Toshkallari: Nuk mund të themi që Bashkia Vlorë nuk e ka pas vëmendjen ndaj Njësisë së Orikumit. Sigurisht që ka nevojë për përmisim, për investime të reja . jemi këtu për të diskutuar për të bërë investime të reja. Drejtor, Keni parashikuar ndonjë projekt për ndërtimin e rrugës së vijës bregdetare?

Drejtor i Urbanistikës Z. Orges Deraj: Është projekt vazhdim i Lungomares.

Kryetari i N.J.A.Orikum, Z.Selim Haskocelaj: Është një rrugë nacionale ka një projekt që pritet të zhvillohet nga qeveria shqiptare .Për SPL të gjithë i duam lirin e hapësirave publike.

Nënkryetarja e Bashkisë Znj. Irena Toshkallari: Këshilltari thotë që të jetë e lirë SPL –ja, por tarifat janë miratuar me vendim të këshillit Bashkiak dhe me dëgjese publike.

Anëtar i Këshillit Bashkiak Z.Arsen Bellaj: Duhet një interpretim që kush quhet e hapur dhe kush quhet e mbyllur.

Lida: E mbyllur me cati me këmbë e vendosur qoftë dhe e dekoruar me vazo dekorative quhet e mbyllur, pasi është bllokim për kalimin e qytetarëve.

Sekretar i Këshillit Bashkiak Z. Daut Zeraj: Janë probleme të trajtuara dhe janë objekt i punës së përditshme të bashkisë Vlorë. Do të rishikohen kur të bëhet konsultimi për paketën fiskale. Të bëhen propozime ku ka emergjenca për investime.

Kryetar i Fshatit Dukat i Ri Z. Fot Gjipali: Kërkojmë investim për ujisjellësin për kalimin e linjës së dytë nga Dukat Fshat pasi ka rënë volumi i ujit, uji është me orar, pjesa e banorëve ngelen 2-3 ditë pa uji. Duhet rregullimi i rrugës “Ali Can”.

Z. Sherif Durmishi: Pjesa e shtetitores në Orikum të trajtohet me prioritet brenda mundësive. Kërkohej gjithashtu vendosja e një tabelë informuese.

Banor: Po ecim drejt turizmit, por disa destinacione turistike kanë nevojë për ndërhyrje. Kisha e Marmiroit ka rrugën që të çon atje të amortizuar dhe kërkon rregullim.

Biznesmen Z.Hariz Kapo: Problem mungesa e ujit dhe investimi në bujqësi, me pak investime inkurajohen shumë fermerë. Nevojë për pastrimin e kanalit vaditës pasi është me resurse bujqësore. Ka disa destinacione turistike që kanë nevojë për ndërhyrje si Kisha e Marmiroit pasi rruga që të con atje është e amortizuar.

Z. Idai Haskocelaj: Shfrytëzojmë ujin e cezmës në mungesë të kanaleve vaditëse

Z. Edison Bitri: Nevojitet ndërhyrje për sinjalistikën në rrugën nacionale Radhimë–Orikum. Gjithashtu, rruga Dukat i Ri – Dukat i Vjetër dhe segmenti përballë varrezave, rreth 500 m, janë pa ndriçim.

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 1407 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUSHICË

DATË 12.08.2025 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, ZV/Kryetari Këshillit Bashkiak-z. Novruz Rrokaj, znj. Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Kryetari i N.J.A.Shushicë, z.Birce Aliraj, Sekretar i Këshillit Bashkiak – z. Daut Zera, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxha, Anëtar të Këshillit Bashkiak, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.
(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur).

Z.Ermal Dredha, Kemi realizuar disa investime në këtë zonë. Një prej tyre është ndërhyrja në pjesën e Bunavisë, e cila u bë e mundur falë angazhimit të Bashkisë dhe institucioneve qendrore. Gjithashtu, është përfunduar segmenti nga Bestrova deri në Bunavi dhe projekti do të vijojë drejt Llakatundit. Në planifikim kemi edhe rrugën e varrezave të Risilisë, e cila ndodhet në procedurë, si dhe rrugën që të çon në Mekat. Për shkak të problematikave që lidhen me ujësjellësin, kemi pasur të pamundur ndërhyrjen në disa lagje të qytetit të Vlorës. Ky është takimi i parë që zhvillojmë për projektbuxhetin 2026. Sot jemi këtu kryesisht për të dëgjuar nga ju se çfarë nevojash apo propozimesh mund të shtojmë. Takimi përfundimtar do të mbahet në muajin shtator, ku do të diskutojmë mbi propozime konkrete për investime në njësinë tuaj.

Z. Birce Aliraj, Rruga e Bunavisë – Ka nevojë për ndriçim.

Grabian – Ka nevojë për ndriçim.

Shushicë – Rikonstruksioni i shkollës është prioritet, së bashku me përmirësimin e bulevardit kryesor dhe trotuareve

Mekat – Problem rruga e brendshme e fshatit.

Drithas – Rruga është përfunduar, por ka nevojë për ndriçim.

Z. Ferdinand Petanaj, Zona jonë është kryesisht bujqësore dhe një nga njësitë administrative më të afërta me qytetin e Vlorës. Megjithatë, bujqësia në Llakatund nuk funksionon si duhet, pasi gropat janë kthyer në mocal. Për më tepër, kanalet kulluese dhe vaditëse ndodhen pa u pastruar, duke krijuar vështirësi për zhvillimin e aktivitetit bujqësor.

Z. Birce Aliraj, Kolektorët kryesorë të lidhur me bordin e kullimit nuk po pastrohen rregullisht. Si pasojë, kanalet e dyta dhe të treta të rrjetit të kullimit nuk mund të hapen dhe funksionojnë normalisht. Të kryhet pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullt e kolektorëve kryesorë, për të siguruar funksionimin normal të gjithë rrjetit të kullimit.

Z. Pajtim Capi, Rruga nga Risili drejt Bunavisë të përforcohet dhe të mbushet me çakëll për të përmirësuar kalueshmërinë.



Znj. Dori Ferhati, Sot hidhet rruga e Xhyherinës në tender.

Znj. Mbarime Tozo, Llakatundn prej kohësh vuajme me mungesën e ujit të pijshëm dhe atij për vaditje. Kjo situatë ka rënduar ndjeshëm jetesën e përditshme, si dhe ka dëmtuar aktivitetin bujqësor.

Z. Birce Aliraj, Të ardhurat ekonomike të shumicës së banorëve të këtyre zonave mbështeten pothuajse në bujqësi.

Z. Bardhyl Qamili banor i fshatit Grabian, duhet një projekt për ndërtimin e rrugës tjetër të fshatit dhe vendosjen e ndriçimit publik.

Z. Kujtim Veizi banor i fshatit Grabian, Nevojë për ujë për vaditjen e tokës.

Znj. Fatmira Hoxha banore e fshatit Shushicë, problem mungesa e ndriçimit publik dhe mungesa e trotuareve në zonë.

Z. Zija Isufaj, banor i fshatit Çeprat, shpreh shqetësimin për mungesën e furnizimit të rregullt me ujë për vaditjen e tokës bujqësore. Furnizimi me ujë ka qenë i cunguar prej kohësh, duke ndikuar negativisht në prodhimtarinë bujqësore dhe punën e fermerëve të zonës. Gjithashtu nevojë urgjente për pastrimin e kanalit vaditës, i cili është bllokuar dhe ka humbur funksionalitetin e ti.

Z. Birce Aliraj, Faleminderit!

Konceptoi:

Aurora Kamberaj

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 14054 prot.

Vlorë, më 27.08.2025

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSELË

DATE 13.08.2025 ORA 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.12237 prot, datë 23.07.2025.

Marrin pjesë:

Kryetar i Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, ZV/Kryetari Këshillit Bashkiak-z. Novruz Rrokaj, znj. Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Kryetari i NJ.A.Novosele- z.Kanan Shakaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak z. Daut Zeraj, Drejtor i Financës – z. Hqmet Haxha, Anëtar të Këshillit Bashkiak, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Z. Ermal Dredha: Përshëndetje,

Kemi filluar procesin e angazhimit në të gjitha rajonet dhe njësitë administrative për të planifikuar se çfarë do të realizojmë vitin e ardhshëm. Deri tani kemi përfunduar 2 rrugë në Cerkovinë dhe Skrofotinë, si dhe rrugën e plazhit të Hidrovorit. Është nisur procedura për rrugën në Trevllazër, por aty ka ende punë për t’u bërë, përfshirë edhe pastrimin e kanaleve. Po ashtu, është realizuar rruga “Ali Ban”. Ndërkohë, rehabilitimi i kanalit në fshatin Mifol mbetet i papërfunduar.

Kemi në plan rikonstruksionin e tregut të gjësë së gjallë në Mifol, si dhe rikonstruksionin e banesave të vjetra për komunitetin në Novoselë.

Jemi në fazën e mbledhjes së ideve dhe sugjerimeve, ndaj ju ftojmë të na jepni indicie mbi prioritetet dhe investimet që mendoni se duhen realizuar për vitin e ardhshëm.



Banor i fshatit Novoselë: Problem mbeten rrugët e brendshme të fshatit, të cilat janë jo funksionale dhe pa ndriçim. Po ashtu, është e nevojshme të bëhet thurra e varrezave të Mifolit.

Banor i fshatit Delisuf: Problem mbeten rrugët e brendshme të fshatit si dhe kanalet kulluese që kanë nevojë për pastrim.

Banor i fshatit Dëllënjë: Problem mbeten rrugët e brendshme të fshatit, rruga që të çon drejt varrezave, si dhe mungesa e ujit të pijshëm.

Banor i fshatit Cerkovinë:

Problem mbetet mungesa e ujit të pijshëm. Ka nevojë për ndërtimin e një depoje të re me kapacitet 100 m³, si dhe për përmirësimin e rrugëve të brendshme të fshatit. Gjithashtu, është e domosdoshme pajisja me një skrep që të vijë në ndihmë për ndërhyrjet e nevojshme.

Banor i fshatit Skrofotinë: Nevojiten 750 m tubo për një lagje, shtrimi i rreth 100 m rruge që të çon te varrezat si dhe asfaltimi i rrugës Skrofotinë–Cerkovinë.

Banor i fshatit Novoselë: Problemi kryesor është kullimi, i cili është në gjendje të mjerueshme dhe duhet të vihet në funksion. Kanaleve u mungon mirëmbajtja dhe janë të bllokuara, ndërsa është e nevojshme vendosja e disa turbinave për tërheqjen e ujërave të zeza. Gjithashtu, Kopshti i Novoselës ka nevojë për ndërhyrje pasi ndodhet jashtë standardeve, ndërkohë që frekuentohet nga rreth 50 fëmijë.

Banor i fshatit Akërnj: Problem kryesor janë kanalizimet e ujësjellësit. Kërkohet ndërhyrje në rrugën e varrezave dhe në rrugën e shkollës që të çon drejt aeroportit. Nevojiten rreth 650 metra .

Banor i fshatit Bishan: Problemi kryesor është kullimi për largimin e ujërave. Rruga drejt varrezave deri në fshat ka nevojë për ndriçim dhe vendosjen e shtyllave.

Znj. Aurora Qarri: Qytetarët po përballen me mungesë të transportit urban, duke u detyruar të përdorin taksi private. Kërkohet që shërbimi i transportit urban të rikthehet, edhe me orar të reduktuar, për të lehtësuar qarkullimin.

Banor i fshatit Fitore: Nevojitet urgjentisht: ndriçim rrugësh, kanalizime për ujërat e bardha dhe të zeza që shkaktojnë përmytje, dhe përmirësim infrastrukture. Deri tani nuk është bërë asnjë investim.

Banor i fshatit Trevllazer: Kemi probleme me furnizimin me ujë, gjendjen e rrugëve dhe nevojë për pastrim të zonës.

Banor i fshatit Poro: Problemet kryesore janë: Kullimi i madh dhe i vogël jo funksional; Mungesa e ujit të pijshëm;

Rrugët e amortizuara dhe të bllokuara nga ferrat;

Rruga lidhëse midis aeroportit dhe qendrës së fshatit kërkon riparim.

Konceptoi:
Aurora Kamberaj
Koordinatorë për Njohim dhe Konsultim Publik

